



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 721, Datë 12.11.2020

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.

**VËREN SE :**

**Transaksioni dhe përqendrimi**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfundimin e kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.

Palët kanë nënshkruar Kontratën e blerjes së degës së biznesit të sistemit softuerik të kamerës më datë 28 shtator 2020.

**Pala Blerëse: Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG**, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman. Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG është pjesë e Grupit Volkswagen i cili drejtohet nga ndërmarrja mëmë fundore e grupit Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG).

Volkswagen AG është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Gjerman.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë.

**Pala Shitëse: Hella Aglaia Mobile Vision GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit Gjerman, dhe me objekt aktiviteti: zhvillimi dhe shitja e zgjidhjeve dhe komponentëve të sistemit të orientuar drejt aplikimit për përpunimin dixhital të imazhit dhe komunikimin e imazhit.

Hella Aglaia Mobile Vision GmbH do të shesë biznesin e sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin (DAS/TSO).

**Garantues i Shitësit: Hella GmbH & Co. KGaA** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman.

**Target:** Dega e biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin.

Më datë 28 shtator 2020, nga pala blerëse Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG, pala shitëse Hella Aglaia Mobile Vision GmbH dhe garantuesi i shitësit Hella GmbH & Co. KGaA është nënshkruar kontrata e blerjes së degës së biznesit të sistemit softuerik të kamerës (duke përfshirë testimin dhe vlerësimin).

Shitësi me anë të kësaj kontrate i shet blerësit, i cili pranon këtë shitje, degën e biznesit DAS/TSO me efekt ekonomik në datën e ekzekutimit.

Dega e shitur DAS/TSO përfshin: (i) asetet, kontratat dhe marrëdhëniet e tjera juridike të shitësit të caktuar për të në përputhje me nenet 2 dhe 3; (ii) punonjësit që janë caktuar në divizionin e DAS/TSO sipas prashikimeve të kësaj kontrate.

Referuar Kontratës së Blerjes do të shiten: asetet materiale, asetet jo materiale, të drejtat e softuerit dhe know-how, kontratat, detyrimet dhe dokumentacioni.

## **Vlerësimi i konkurrencës**

Transaksionin i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG. Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG nuk operon në Shqipëri. Target nuk operon në Shqipëri

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**